

Kthimi i afshit



Dr. Bettina Exel Specialiste për shëndetin dhe higjienën e kafshëve

Përkthyer dhe përpunuar nga Olger Nanagjoka

Kthimi i afshit tek dosa ose kafshët e tjera të cilat gjatë kontrollit të barsmërisë rezultuan negative shkaktuan shpenzime të padëshiruara (për kthimin në afsh shpenzimet shkojnë deri në 60€ duke llogaritur këtu edhe shpenzimet e stallës), duke ulur rendimentin e tufës dhe duke zvogëluar prodhimin bujqësor. Dosat që kanë pasur një kthim aciklik të afshit (mbas 3 apo 6 javëve) ose dallohen me vonesë që janë shterpë, kanë probleme të adaptimit në tufë.

Problemet e kthimit të afshit janë të shumëllojshme. Si psh: dosat e dobëta, MMA, infeksionet, temperatura e lartë, gregullime të metabolizmit, rënia e imunitetit, gjithashtu mbeten për t'u përmendur dhe sëmundjet dytësore virale dhe bakteriale.

Shkaqet për rritjen e kthimit në afsh

- Menaxhimi i ndërzimit: Mangësi në identifikim gjatë periudhës së afshit, ndërzim në kohën e gabuar, përdorimi i katetrave të ndotura (të papastër), ndërzimi i

nxituar, stresi

- Kur temperatura e stallës është e lartë
- Kur dosat janë të dobëta
- Kur dosat janë të reja
- Adaptimi në tufë i dosave të reja
- Ngordhja e embrionit (kthimi i afshit në 28 ditë ku duhet të jetë dhe dita e barsmërisë) Stresi, Mykotoksina në ushqim, viruset, një mitër më pak e sforcuar (nën 5 embrione shpesh është inseminuar vonë)
- Kist (afshi tek dosat është shumë i gjatë)
- Rrjedhje (MMA, Endometrit)
- Materiali biologjik që nuk ka aftësi për tu fekunduar (cilësia e materialit biologjik, ruajtje e gabuar)

Këshilla të përgjithshme

1. Procesi i inseminimit duhet të zhvillohet në qetësi dhe nuk duhet të shkaktojë stres tek dosa. Inseminimi duhet të shoqërohet nga prania e një harci në mënyrë që dosa të stimulohet mjaftueshëm.
Mbas ndërzimit dosa ka nevojë të qëndrojë në qetësi (në box individual)
2. Në temperatura të larta gjatë muajve të verës dhe në temperatura të ulëta gjatë muajve të dimrit, rrymat e ajërit në stallë (pasohet me infeksion në rrugët urinare dhe në mitër) dhe përqindja e lartë e gazit të dëmshëm, ulin efektshmerinë e dosës dhe nxisin shfaqjen e sëmundjeve të ndryshme.
3. Procesi i të ushqyerit duhet ti përshtatet cdo dose duke iu përshtatur parametrave të saj si dhe fazës së riprodhimit. Mungesa e ushqimit cilësor si psh. drithërat që përmbajnë mykotoksina ndikojnë në uljen e rendimentit.

Flushing- Ushqimi

Gjatë fazës së shkëputjes ushqimi duhet të reduktohet për cdo vakt nga 1 deri në 2 kg. Mbas kësaj dosa ushqehet pa kufi me ushqim, për dosat në laktacion deri në momentin e ndërzimit. Nëpërmjet kësaj mënyre të ushqyerit (rritje të energjisë), mbas shkëputjes nxitet procesi i afshit, pakësohen ditët në laktacion dhe shumohen vezët pjellore nga vezorja.

Shumë ferma përvec racionit për dosat në laktacion i shtojnë energjitë nëpërmjet

misrit ose silazhit të misrit kokërr.

Dosat e reja

Dosat e reja na tregojnë shpeshherë para afshit të parë shenja paraciklike si psh: skuqje të lehta dhe të enjtura të vulvës. Shenjat që vijnë nga stimulime të ndryshme si p.sh. transporti. Kjo ngatërrohet shpesh me periudhën e afshit. E rëndësishme është testimi i reflekseve të palëvizshmërisë. Tek paradosat nuk duhet të përdorim afshin e parë për ndërzim. Mund të arrijmë një pjellje optimale direkt pas ciklit të 2 dhe të 3. Tek e Bardha e Madhe (LARGE WHITE) procesi i ndërzimit ndodh më vonë. Ndërzimi i parë duhet të bëhet pas 240 ditësh ose kur dosa ka arritur peshën 130 kg.

1. Ndërtimi i stallës, madhësia e grupit, hapësira e disponueshme për cdo kafshë, dhënia e ushqimit dhe sistemimi i pirëseve të ujit mund të jenë faktorë që shkaktojnë stres. Kjo prek në të shumtën e rasteve dosat të cilat në stallën e ndërzimit mbahen në grupe, individuale të vecuar të cilët shpeshherë privohen nga tufa gjatë të ushqyerit. Kur këto pengesa rriten atëherë rritet dhe numri i ngordhshmërisë embrionale i cili con në pjellori të ulët ose ndërprerje të barsmërisë e cila mund të shoqërohet edhe me kthim në afsh.
2. Në shumicën e fermave ambienti i stallave është i ftohtë. Në këto ferma infeksionet në rrugët urinare janë të përditshme duke shkaktuar kthim në afsh. Shpesh stallat nuk janë të izoluara mirë. Pa ngrohje dhe pa ajrim nuk krijohet thatësia e duhur në keto stalla. Temperatura minimale e stallës duhet të jetë 20° C.
3. Një mbajtje e rregullt e materialit biologjik. Cilësia e materialit biologjik të harcit dëmtohet nga:
 - Temperatura e harcit.
 - Parazitët (krimba, sarcoptes etj)
 - Infeksionet (në testikuj dhe në rrugëturinare...)
 - Ushqim i prishur
 - Gjak në ejakulat
 - Qëndrimi në kushte të këqija
 - Të ushqyerit
 - Mbajtja në errësi
 - Kërkesa të larta (marrja jo më shumë se 3 herë në javë e materialit)